

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Sabedin Mushica, sekretaren juridike Adelina Brestovci, në çështjen kontestimore të paditësit Sh. Rr. nga fshati, Komuna e Gjilanit, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria e Arsimit në Gjilan, të cilën me autorizim e përfaqëson Arben Mehmeti nga Gjilani, me objekt kontesti kompesim i tri pagave mujore për përcjellje në pension etj, vlera e objektit të kontestit 3.318.72 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 14.12.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar në ligj, kërkesëpadia e paditësit Sh. Rr. nga fshati, Komuna e Gjilanit dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Gjilanit- Drejtoria e Arsimit në Gjilan që paditësit t'ia paguajë edhe atë: për shpërblimin jubilar tri paga në vlerë prej 1.426.86 € (Njëmijë e katërqindë e njëzet e gjashtë euro e tetëdhjetë e gjashtë cent), për përcjellje në pension tri paga në vlerë prej 1.426.86 € (Njëmijë e katërqindë e njëzet e gjashtë cent), të gjitha këto në vlerë të tërësishme prej 2.853.72 € (dy mijë e tetëqindë e pesëdhjetë e tre euro e shtatëdhjetë e dy cent), me kamatë ligjore ashtu sa paguajnë Bankat Afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimit e deri në pagesën definitive edhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET e pabazuar në ligj, pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket për shpërblimit jubilar për tri paga dhe përcjelles në pension për tri paga në shumë prej 345.00 Euro(treqindë e katërdhjet e pesë euro) si dhe pagesën e regresit në shumë prej 120.00 €, e kërkuar më tepër se shumata e gjykuara.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Kronologjia e çështjes

Paditësi Sh. Rr. nga fshati, Komuna e Gjilanit me datë 10.05.2016, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, sipas së cilës ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e tij dhe të detyrohet pala e paditur Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditësit t'ia paguaj tri paga mujore në shumë të tërësishme prej 1,599.36 €, për shpërblim jubilar tri pagesa mujore për përcjellje në pension në shumë prej 1,599.36 € si dhe regresin në shumë prej 120€, në total prej 3,318.72 € bruto, dhe ka kërkuar që ti paguhen shpenzimet gjyqësore dhe kamata sipas shkallës që e paguan banka për depozitim mbi 1 vit, duke filluar nga dt. 05.05.2016 gjerë në ditën e pagesës. Të gjitha shumata e kërkuara më lartë ti paguhen në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje¹ lidhur me pretendimet e saj. Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi

¹ Sipas aktvendimit Cnr.437/2016 të datës 22.06.2016, lënda është pezulluar për 180 ditë dhe është njoftuar Ministria e Drejtësisë, në pajtim me nenin 68 lidhur me nenin 67 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e cila në afatin e paraparë nuk është paraqitur.

kërkesëpadinë e paditësit për arsye se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit- pensionimi, me dt. 25.01.2016, me aktvendimin e Drejtorisë së Arsimit në Gjilan, ndërsa edhe pse në këtë aktvendim nuk është paraparë pagesa e këtyre pagave si dhe regresi ndaj të njëjtit nuk është paraqitur ankesë nga ana e paditësit edhe pse e ka pasur këtë këshillë juridike në aktvendim. Ekzekutimin e pagave e bënë Ministria e Financave- Divizioni i Pagave në kuadër të kësaj Ministrie, mirëpo për shkak se ende nuk është duke u zbatuar kontrata kolektive për sa i përket këtyre pagave kjo ministri nuk po i ekzekuton të njëjtat.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paraqitur në këtë gjykatë duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta aprovojë si të bazuar, ashtu që ata obligoj të paditurën Komuna e Gjilanit të ia paguaj tri paga mujore në shumën e tërësishme prej 1,599.36€ për shpërblim jubilar, tri paga mujore për përcjellje në pension në shumë prej 1,599.26 € si dhe regresin në shumë prej 120,00 € në total prej 3,318.72 € me kamatë ligjore si paguajnë bankat për depozitim mbi një vit duke filluar nga data 10.05.2016 e deri në ditën e pagesës.

Përfaqësuesi i të paditurës, Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Arben Mehmeti gjatë shqyrtimit gjyqësor ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi të ushtruar në këtë gjykatë dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata ka lexuar dhe administruar këto prova: Aktvendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër 05 NR 061-1124/2015 i datës 06.01.2015; Vërtetimin e lëshuar nga DKA me numër 05-061-37148 i datës 21.04.2016; Vërtetimin e lëshuar nga Fillore e Mesme e Ulët “Agim Ramadani” në fshatin me numër 25 i datës 19.04.2016; Kërkesë drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Gjilan e datës 22.03.2016; Përgjigjjen në kërkesë me numër 05-061-26920 e datës 13.04.2016 nga DKA Gjilan; Kopjen e librezës së punës me numër 607835 e cila është në 4 fletë.

Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se paditësi Sh. Rr., sipas fuqisë ligjore edhe atë Aktvendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër 061/1124/2016 i datës 06.09.2016, i ka përfunduar marrëdhënia e punës, me datë 25.01.2016, pasi që ka mbushur moshën 65 vjeçare.

Nga kërkesa e drejtuar DKA-së, e datës 22.03.2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësi i është drejtuar organit kompetent që t’i njihet e drejta lidhur me lartësinë e pagave mujore pas pensionimit.

Nga përgjigjja në kërkesë e DKA-ës në Gjilan me numër 05-061-26920 e datës 13.04.2016 gjykata vërtetoi faktin se e paditura ka shqyrtuar kërkesën e paditësit, mirëpo në të njëjtën është përgjigjur se ekzekutimin e këtyre pagave e bënë Minsitria e Financave gjegjësisht Divizioni i pagave.

Nga vërtetimi me numër 25/2016 i datës 19.04.2016, i lëshuar nga Shkolla e Fillore e Mesme e Ulët “Agim Ramadani” në fshatin Zhegër, Komuna e Gjilanit, gjykata vërtetoi se paditësi ka qenë mësues në këtë shkollë edhe atë që nga viti 1971 e deri në vitin 2016.

Nga vërtetimi me numër 05-061-37148 i datës 21.04.2016 i lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit i Komunës së Gjilanit, gjykata vërtetoi se paditësi ka qenë i punësuar në Shkollën Fillore/Mesme “Agim Ramadani” në fshatin Zhegër, Komuna e Gjilanit edhe atë që nga viti 1971 e deri me 25.01.2016 me gjithsej 44 vite e 4 muaj e 25 ditë përvoj pune.

Nga librezat e punës e datës 02.04.1971 gjykata vërtetoi faktin se paditësi ishte në marrëdhënie pune në cilësinë e mësimdhënësit që nga viti 1971.

Gjykata vlerësoi me kujdes të thënat nga ana e paditësi Sh. Rr., e në lidhje Kontratën Kolektive e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2015, dhe për këtë arsye pjesërisht e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kompensimit të tri pagave për shpërblim jubilar shumë prej 1.426.86 € (Njëmijë e katërqindë e njëzet e gjashtë euro e tetëdhjetë e gjashtë cent), dhe përcjelle në pension tri paga edhe atë në vlerë prej 1.426.86 € (Njëmijë e katërqindë e njëzet e gjashtë cent), të gjitha këto në vlerë të tërësishme prej 2.853.72 € (dy mijë e tetëqindë e pesëdhjetë e tre euro e shtatëdhjetë e dy cent), duke u bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit Para Universitar, respektivisht nenit 36 par.9 nën par.9.3 dhe par.10 të kësaj kontrate, ku të njëjtën e kanë nënshkruar kryetari i SBASHKUT në njërin anë kurse në anën tjetër Ministri i Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, ku në mes tjerash në nenin 2 paragrafi 1.1 parashihet se “Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar, parashkollor, fillor, të mesëm...” e në rastin konkret paditësi ka qenë mësimdhënës i rregullt në Shkollën e Mesme të Ulët “Agim Ramadani” në fshatin Zhegër, Komuna e Gjilanit.

Për lartësinë e aprovuar gjykata mori si të besueshëm faktin e deklarimit të paditësit gjegjësisht Vërtetimin e lëshuar nga Drejtori i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “ Agim Ramadani” numër 25/2016 të dt. 19.04.2016, ku sipas këtij Vërtetimi paditësi Sh. Rr. ka punuar në këtë shkollë e që sipas listës së pagave, paga e tij e tij neto ka qenë në vlerë prej 475.62 € dhe nga një llogaritje e thjeshtë² del shuma si në dispozitivin e I të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të të paditurës gjykata nuk e muar për bazë për faktin se është e vërtetë se Komuna e Gjilanit nuk është nënshkruese drejtëpërdrejtë e ndonjë marrëveshje kolektive, mirëpo nënshkruese e kontratës kolektive Para Univeristar është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjise, e cila është në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku në nenin 2 paragrafin 1.2 Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar parashihet “Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit, DKA dhe MASHT..” e në rastin konkret i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune pranë Komuës së Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan –DKA.

Përderisa refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kërkesës së kërkuar lidhur me rastin për përcjelle në pension tri paga dhe shpërblim jubilar për tri paga në shumë prej 345.00 Euro (treqindë e katërdhjetë e pesë euro), me arsyetimin se sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “ Agim Ramadani” numër 25/2016 të dt. 19.04.2016, shihet se paditësi Sh. Rr. sipas listës së pagave, paga bruto e të njëjtit ka qenë 533.12 euro, kurse paga neto 475.62 euro, andaj gjykata ka llogaritur pagën neto se sa i ka realizuar paditësi, po ashtu sa i përket regresit, në Kontratën Kolektive të Arsimit Para Universitar në asnjë dispozitë të kësaj kontrate kolektive nuk

² Tri paga përcjelle në pension dhe tri paga për shpërblim jubilar, ku sipas vërtetimit me numër numër 25/2016 të dt. 19.04.2016, është konstatuar se të ardhurat mujore neto për paditësin kanë qenë në shumë prej 475.62 Euro dhe të njëjtat gjatë shumëzimit edhe atë $475.62 \times 6 = 2.853.72$ Euro.

është potencuar se punëtorët që dalin në pension kanë të drejtë të përfitojnë edhe regresin në shumë prej 120,00 € dhe nga këto të lartcekura gjykata vendosi *si në dispozitivin e II* të këtij aktgjykimi.

Dispozitat ligjore të aplikueshme

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësit, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar konkretisht nenin 36 par.9 nën par.9.3 dhe par 10, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të procedurës kontestimore në fuqi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muar konform nenit 450 të LPK-ës, me arsyetimin se asnjëra nga palëve nuk i kërkoi të njëjtat, po ashtu gjykata nuk e ka obliguar paditësin që të paguajë taksë gjyqësore për padi, konform nenit 7.2 pika b), të udhëzimit administrative me numër 2008/02, për shkak se hartimin e padisë dhe çdo kërkesë tjetër drejtuar institucioneve relevante i ka hartuar Zyra për Ndihmë Juridike Falas në Gjilan.

Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar edhe në nenin 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

C.nr.437/2016

Me dt.14.12.2017

Gjyqtari,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.